



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datë **28.10.2014**, Mekanizmi Parandalues Nacional, realizoi vizitë të paparalajmëruar në SP Demir Hisar (e cila është vizita e parë e realizuar nga ekipi i MPN në këtë stacion policor).

Qëllimi i vizitës, në përputhje me Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese, është identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Vizita në stacionin policor u realizua në atë mënyrë që fillimisht u bë kontroll në hapësirat për ndalim, më pas u zhvillua bisedë me ndihmës kryeshefin e SP (i cili e kryente funksionin e kyeshefit të stacionit policor), dhe pastaj zbatoi kontroll edhe në disa regjistra dhe evidenca:

- Evidenca për ngjarjet e ditës;
- Evidenca për personat e privuar dhe të ndaluar;
- Regjistri për përdorimin e mjeteve të dhunshme, dhe
- Evidenca për personat e arrestuar, si dhe
- 4 dosje individuale për personat e ndaluar.

Në këtë stacion policor ka 1 hapësirë për ndalim individual me një krevat. Gjatë kohës së vizitës në SP Demir Hisar nuk kishte persona të ndaluar të vendosur në vendin përkatës për ndalim, me të cilët ekipi i MPN-së do të mund të zhvillonte bisedë rreth trajtimit të tyre nga ana e nëpunësve policorë dhe kushtet e ndalimit në këtë stacion policor. Hapësira i plotëson standardet për vendosjen e personave të ndaluar sa i përket madhësisë.

Gjatë inspektimit të hapësirës për ndalim, ekipi i MPN-së konstatoi se e njëjta është e pajisur me krevat, i cili është i fiksuar për dysheme, me çka pamundësohet keqpërdorimi i tij. Krevati është i pajisur me mjete pjesshëm të pastra dhe të rregullta për pushim (për ndalime të shkurtra dhe gjatë natës), siç janë: batanije, jastëk, mirëpo krevati nuk kishte dyshek dhe shtroje por vetëm sfungjer dhe disa batanije të vjetra.

Sa i përket ndriçimit, hapësira i plotëson standardet të cilat kanë të bëjnë me ndriçimin natyror dhe artificial, megjithatë, në kuadër të hapësirës nuk është vendosur ventilator për pastrimin e ajrit, dhe ventilimi bëhet në mënyrë natyrore përmes pjesës së hapur lartë në derë. Në hapësirën për ndalim nuk është instaluar as sistem i veçantë qendror për ngrohje dhe ftohje. Gjatë vizitës, MPN-ja konstatoi se temperatura është nën nivelin e shtrirjes së pranueshme, prej rreth 16.5°C, ndërsa lagështia e ajrit është 62% e që është mbi vlerat e rekomanduara.

Në këtë hapësirë nuk ka të instaluar sistem për thirrje (interfon), ndërsa zyra e udhëheqësit të turnit gjendet në pjesën përdhese dhe së këtëjmi shtrohet pyetja se në ç'mënyrë personat

e ndaluar e njoftojnë nëpunësin policor për nevojat e tyre urgjente, duke e marrë parasysh se hapësira për ndalim gjendet në hapësirat e bodrumit.

Ekipi i MPN-së, gjatë kontrollit të hapësirës për ndalim, sikurse edhe në hapësirat e tjera zyrtare, nuk vërejtí mjete me të cilat mund të kryhet frikësimi ose sende tjera të dyshimta.

Evidenca për ngjarjet e ditës mbahet shumë me rregull, të gjitha kolonat e formularit ishin të lexueshme dhe të plotësuara qartë, ka përshkrim të detajuar të ngjarjes dhe i përmban të gjitha informatat e nevojshme me nënshkrimin e nëpunësit policor, i cili i ka plotësuar të dhënat në fjalë. Pasqyra e këtij libri jep një pamje të qartë për të gjitha aktivitetet dhe punët të cilat kanë të bëjnë me fushëveprimin e PS Demir Hisar.

Gjatë kontrollit të Evidencës për personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, ekipi i MPN-së konstatoi se e njëjta mbahet me rregull, të gjitha rubrikat janë plotësuar në mënyrë të azhurnuar dhe të lexueshme dhe se nuk përdoret korrektori. Pozitive është ajo se në këtë evidencë, në rubrikën për mjekun, ceket se për ç'arsye është thirr mjeku. Nga evidencia e njëjtë nuk vërehej qartë se a bëhet fjalë për kategori të personave të privuar nga liria apo personave të ndaluar ishte vënë qartë kategoria e personit, përkatësisht nuk ishte potencuar se a bëhet fjalë për person të ndaluar ose vetëm person të privuar nga liria.

Kontrolli i dosarëve individual u zbatua sipas përzgjedhjes së rastit, me ç'rast u konstatua se ata mbahen me rregull, dhe se përveç procesverbalit për ndalim është bashkëngjitur një numër i madh i dokumenteve të cilat kanë të bëjnë me ndalimin e personit dhe realizimin e të drejtave të tij në procedurën policore. Në disa dosarë, MPN-ja vërejtí edhe ekzistimin e procesverbalit që ka të bëjë me të drejtën e mjekut, si dhe raportin e shkruar për anamnezë mjekësore dhe masat e ndërmarra nga ana e mjekut me nënshkrim dhe faksimil, e që është praktikë e mirë dhe e njëjta duhet të merret si shembull dhe të praktikohet edhe në stacionet e tjera policore .

Për vizitën, Mekanizmi Parandalues Nacional përgatiti raport të veçantë në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia drejtoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe vet stacionit policor, me qëllim të eliminimit të mangësive të konstatuara.